



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:023971

Datë: 07.12.2022

Numri i dokumentit: 03723715

**C.nr.465/22**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Shaban Shala, me praktikantin A.B. duke vendosur në çështjen juridike civile të paditësit G.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të pagës së 13-të dhe shujtave ditore, me vlerë të kontestit 1.715.70 € euro, më datën 07.12.2022, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PËR SHKAK TË MOS BINDJES**

**PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar** kërkesë padia e paditësit **G.K. nga Prizreni** dhe **OBLIGOHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019 dhe 2020 t’ia paguaj shumën në lartësi prej **1.715.17 €** (njëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë (07.02.2022) deri në përmbushjen në tërësi të detyrimit të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**REFUZOHET si e pa bazuar** kërkesë padia e paditësit **G.K. nga Prizreni**, me të cilën ka kërkuar që e paditura t’ia kompensojë ushqimin për punë-shujtat për vitet 2018, 2019 dhe 2020 në shumën prej 1.612.5 € (njëmijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent).

**DETYROHET** e paditura që t’ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në shumën e përgjithshme prej 124 € (njëqind e njëzetë e katër euro), të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**A r s y e t i m**

Paditësi G.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria për Personel, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, me vlerë të kontestit 3.500.24 €.

Gjykata të paditurës ia ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi të cilit ia ka bashkangjitur padinë dhe provat materiale dhe atë: vërtetimin për ditët e pranisë në punë, formularin e vlerësimit të performancës për periudhat kohore 11.04.2018 deri me datë 01.01.2019, 01.11.2019 deri me datë 31.12.2019 si dhe 11.06.2020 deri me datë 31.12.2020, kërkesën e ushtruar ndaj të paditurës për kompensimin e ushqimit gjatë orarit të punës dhe pagën e 13-të për vitet 2018, 2019 dhe 2020 dhe vendimin e të paditurës për refuzimin e kërkesës, të cilin aktvendim për përgjigje në padi së bashku me provat materiale të cekura më lartë e paditura i ka pranuar me datë 01.04.2022 i cili fakt vërtetohet nga fletëkthesa për dorëzim personal të cilën e ka nënshkruar përfaqësuesi i të paditurës, e cila brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

Andaj duke marrë për bazë këtë fakt se e paditura nuk ka dhënë përgjigje në padi brenda afatit ligjor, ndërsa asaj rregullisht i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesë padisë sa i përket dispozitiv nën I të aktgjykimit, pra detyrimi për pagimin e pagës së trembëdhjetë në shumën e vendosur si në dispozitiv rrjedh nga faktet e treguara në padi të cilat vërtetohen nga provat materiale e të cilat fakte nuk janë në kundërshtim me provat nga padia, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 150 par.1 pikat a, b dhe c të LPK-së.

Më rastin e vendosjes gjykata morri për bazë posaqërisht formularin e vlerësimit të performancës për periudhat kohore 11.04.2018 deri me datë 01.01.2019, 01.11.2019 deri me datë 31.12.2019 dhe 11.06.2020 deri me datë 31.12.2020, e duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, sipas nenit 29 par.2, e cila dispozitë përcakton se personelit të policisë, i cili ka marrë vlerësim të kënaqshëm i takon të përfitoj si shpërblim jubilar një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Paditësi e ka plotësuar këtë kusht ku ka treguar performancë shumë të mirë gjatë vitete 2018, 2019 dhe 2020.

Ndërsa sa i përket kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e ushqimit në punë, gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën, me arsyetimin se mungon baza juridike lidhur me kërkesës prej 2.5 euro për një shujtë ditore bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 ku neni 29 par.1 përcakton të drejtat në pagë dhe shpërblimet që i takojnë personelit të Policisë së Kosovës, ku ndër tjerash ceket se personelit të Policisë i takon edhe shujta ditore, mirëpo nuk është e precizuar shuma e shujtës për një ditë pune.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (07.02.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020 , pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së e të cilat përfshijnë: 20 € në emër të taksës gjyqësore dhe 104 € në emër të përpilimit të padisë bazuar në Tarifën e Odes së Avokatëve të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.465/22 datë 07.12.2022**

**Praktikanti**  
**Ardi Brando**

**Gjyqtari**  
**Shaban Shala**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejt ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.